

Znj. Eva Mene

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 6744 prot., datë 10.10.2022 drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ju informojmë se:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik, i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ka si qëllim mbrojtjen sociale, menaxhimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe dhënien e përfitimeve për të gjithë personat të cilët janë kontribues në skemën e sigurimeve shoqërore dhe kanë plotësuar kushtet për përfitime nga kjo skemë.

Sa më sipër, çështja që keni adresuar për informacion, *(nëse do të ketë ndikim në rritjen e pagës në administratën shtetërore, vitet e punës për të cilat keni derdhur kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, si person juridik në biznesin tuaj)*, nuk është kompetencë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, por e institucionit në të cilin jeni punësuar.